

**AKT THEMELIMI  
DHE  
STATUTI I SHOQËRISË**

**“DURANA TECH PARK“ SH.A.**

Sot, në datë 18.02.2025 nënshkruhet ky Akt Themelimi dhe Statut i shoqërise “DURANA TECH PARK” SH.A. nga:

**“Korporata e Investimeve Shqiptare” SHA**, shoqëri aksionare e të drejtës shqiptare, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) më 17.07.2020, me NIPT M01917011D dhe seli në adresën Rr. Ibrahim Rugova 5, Sky Tower 7/1, Tiranë – Shqipëri; përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv – Znj. Elira KOKONA,

*Nga këtu e në vijim referuar si AIC –*

Në cilësinë e aksionerit të vetëm të shoqërisë **DURANA TECH PARK SH.A.** i cili ka vendosur të miratojë dhe nënshkruajë këtë akt themelimi dhe statut në përputhje me dispozitat si më poshtë :

**HYRJE**

Shoqëria Tregtare “ DURANA TECH PARK ”SH.A. rregullon pozitën e saj juridike, të organeve te saj, kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj, strukturën dhe organizimin e brendshëm duke u bazuar në ligjin nr. 71/2019 “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare, Vendimin nr. 137, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfiteozë, leasing, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në forma të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare”, të ndryshuar, ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare “, i ndryshuar si dhe dispozitat e tjera të legjislationit shqiptar në fuqi që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e shoqërive tregtare.

**MISIONI**

Misioni i DURANA TECH PARK Sh.A. është menaxhimi i parkut teknologjik dhe shkencor “DURANA TECH PARK” në fazën virtuale dhe atë hibride, si dhe zhvillimi i tij për ato funksione që do ti transferohen/delegohen nga Zhvilluesi i Parkut.



## KREU I TË PËRGJITHSHME

### Neni 1 Përkufizime

1.1 Për qëllimet e këtij Statuti dhe për të shmangur çdo paqartësi eventuale, termat e përdorur, kanë kuptimet si më poshtë vijon:

“**Administrues / Menaxhues**” është Durana Tech Park SH.A. e organizuar sipas këtij statuti dhe sipas përcaktimeve të Legjislacionit të Zbatueshëm i cili kryen funksionet e Menaxhuesit të Parkut Teknologjik dhe Shkencor Durana Tech Park sipas parashikimeve të këtij akti dhe akteve të delegimit të Zhvilluesit të Parkut.

“**Asamble**”, është Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve të Shoqërisë.

“**Autorizim**” është çdo miratim, leje, licencë, autorizim, certifikatë dhe / ose akt tjetër administrativ i nevojshëm për ushtrimin e aktivitetit të Shoqërisë.

“**Buxhet**” është buxheti aktual i shpenzimeve kapitale dhe buxheti operativ i miratuar në Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve bazuar në propozimin e Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë.

“**Data e Themelimit**” është data e nënshkrimit të këtij Statuti nga aksioneri i vetëm AIC.

“**Ditë Pune**”, janë të gjitha ditët e javës, përveç të shtunës, të dielës dhe ditëve të festave zyrtare në Republikën e Shqipërisë.

“**DURANA Tech Park**” është parku teknologjik dhe shkencor i miratuar nëpërmjet VKM Nr. 185, datë 27.03.2024.

“**E Drejtë Parablerje**”, ka kuptimin e dhënë nga Neni 14 i këtij Statuti.

“**Humbje**” është çdo humbje ose dëmtim i drejtpërdrejtë ose të tërthortë sipas dispozitave të Kodit Civil dhe Ligjit të Zbatueshëm, duke përfshirë, por jo kufizuar në, çdo kosto, shpenzim, pagesë, humbje, ose detyrim që është rezultati drejtpërdrejtë ose i tërthortë i shkeljes së përfaqësimeve, garancive, ose dispozitave të tjera në këtë Statut.

“**Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL)**”, janë personat juridik që ofrojnë arsim të lartë, në përputhje me përkufizimin e ligjit nr. Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.

“**Këshill**” është Këshilli Mbikëqyrës i Durana Tech Park SH.A.

“**Komiteti për partneritet në zonat ekonomike dhe parqet teknologjike (KPZET)**” është Komiteti që rregullohet sipas Rregullores për Përzgjedhjen e partneriteteteve për zhvillimin/menaxhimin/administrimin/ dhe përzgjedhjen e përdoruesve të një parku



teknologjik/zone ekonomike nga Korporata e Investimeve Shqiptare, në cilësinë e zhvilluesit të autorizuar dhe Rregullores së funksionimit të KPZETT për partneritetet në zonat ekonomike dhe parqet teknologjike.

**“Kontrata e menaxhimit”** është kontrata që lidhet midis Zhvilluesit dhe Menaxhuesit me qëllim menaxhimin dhe zhvillimin e parkut.

**“Kontrata e Partneritetit”** është kontrata që lidhet ndërmjet Zhvilluesit / Menaxhuesit dhe partnerëve të tretë të mundshëm;

**“Kufiri i ulët monetar” / “Kufiri i lartë monetar”** është vlera monetare e përcaktuar nga legjislacioni i prokurimit publik në fuqi në RSH për kontratat e punëve publike dhe për kontratat publike të shërbimeve dhe mallrave.

**“Legjislacioni i Zbatueshëm”** do të thotë çdo ligj dhe akt ligjor e nënligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë që lidhet me krijimin e Shoqërisë dhe realizimin e qëllimit të saj, duke përfshirë por pa u kufizuar në Ligjin nr. 71/2019, *“Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”* dhe aktet e nxjerra në zbatim të tij; Ligjin nr. 55/2015, *“Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar dhe aktet e nxjerra në zbatim të tij; Ligjin nr. 58/2022 *“Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Parqeve Teknologjike dhe Shkencore”* dhe aktet e nxjerra në zbatim të tij; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 337, datë 31.05.2023 *“Për përcaktimin e procedurave dhe kritereve të përzgjedhjes së Zhvilluesit të Parqeve Teknologjike dhe Shkencore”*, i ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 416, *“Për miratimin e kritereve, rregullave dhe procedurave për përfitimin e lehtësirave fiskale nga Zhvilluesit dhe Përdoruesit që operojnë në Parqet Teknologjike dhe Shkencore”*; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 418, datë 7.7.2023 *“Për miratimin e procedurave për përzgjedhjen e Përdoruesit në Parqet Teknologjike dhe Shkencore”*; si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 185, datë 27.3.2024 *“Për kalimin nga Radiotelevizioni Shqiptar në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, të pasurive të paluajtshme shtetërore nr. 336, nr. 338/1, nr. 318, në Zonën Kadastrale 3852, Xhafzotaj, Bashkia Durrës, dhe miratimin e hapjes së Parkut Teknologjik dhe shkencor “Durana Tech Park”*, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 13, datë 09.01.2025 *“Për transferimin në pronësi të Korporatës së Investimeve Shqiptare të pasurive të paluajtshme shtetërore nr. 336, nr. 338/1, nr. 318, nr. 324/4, nr. 324/2, nr. 310, në zonën kadastrale 3852, Xhafzotaj, Bashkia Shijak, dhe për disa ndryshime në Vendimin nr.185, datë 27.3.2024, të Këshillit të Ministrave “Për kalimin nga Radiotelevizioni Shqiptar në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, të pasurive të paluajtshme shtetërore nr. 336, nr. 338/1, nr. 318, në zonën kadastrale 3852, Xhafzotaj, Bashkia Durrës, dhe miratimin e hapjes së parkut teknologjik dhe shkencor “Durana Tech Park”*, aktet e nxjerra në bazë dhe për zbatim të tij, si dhe çdo akt i organeve drejtuese të Durana Tech Park SH.A. si dhe çdo akt të Entiteteve Qeveritare, përfshirë, ligje, akte nënligjor, urdhëresë, dekret, rregullore, udhëzim, autorizim ose aprovim tjetër nga një Entitet Qeveritar që ka juridiksionin dhe autoritetin e duhur mbi Palët, të nxjerra në kohën e miratimit të këtij Statuti apo në kohë të mëvonshme për aq sa janë të zbatueshme.

“Ligji i Parqeve Teknologjike dhe Shkencore” është Ligji Nr. 58/2022 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Parqeve Teknologjike dhe Shkencore”.

“Lista e Përdoruesve të Parkut” është lista e subjekteve të cilët në bazë të një kontrate të vlefshme të lidhur me Durana Tech Park S.H.A. janë të regjistruar në territorin e Parkut me Nipt/NUIS parësor dhe me NIPT/NUIS sekondar në territore të ndryshme nga territori i Parkut dhe ushtrojnë veprimtaritë e lejuara në Park në cilësinë e biznesit rezident në park, start-up rezident në park apo IAL së përfshirë në Park. Lista e Përdoruesve të Durana TECH PARK S.H.A. administrohet nga Zhvilluesi/Shoqëria dhe i njoftohet Entiteteve Qeveritare sipas parashikimeve të Marrëveshjes me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit apo sipas kërkesës.

“Mbledhje”, është çdo mbledhje e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të Shoqërisë, ose Këshillit Mbikëqyrës, varësisht përdorimit në dispozitën përkatëse të këtij Statuti.

“Përdorues” janë të gjithë personat fizikë ose juridikë vendas ose të huaj, të cilët do të ushtrojnë veprimtari brenda Parkut Durana, duke lidhur kontratën përkatëse me Menaxhuesin për këtë qëllim në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm.

“Person” është çdo individ, shoqëri, ent ligjor, fond, fondacion, trust ose ent tjetër i ngjashëm, Ent Qeveritar ose sipërmarrje tjetër e përbashkët, shoqatë apo partneritet (*pavarësisht nëse kanë ose jo personalitet juridik të veçantë*).

“Plani i detajuar i Zhvillimit” është plani i detajuar i zhvillimit të DURANA Tech Park, i cili hartohet në formën e një projekti konceptual teknik dhe përmban analizën e gjendjes aktuale, listën e ndërhyrjeve të propozuara, si dhe projekt-idenë arkitektonike për zhvillimin e parkut. Projekti konceptual hartohet i detajuar mjaftueshëm për të kuptuar dhe vlerësuar realizueshmërinë e tij. Plani, ndër të tjera përmban, të dhëna mbi vlerën e investimit, burimin dhe mënyrën e financimit, përdoruesit potencial, rolin specifik të IAL - ve apo entiteteve të formimit profesional, startup, plan-biznesin, partneritete të mundshme, grafikun, fazat dhe afatet e ekzekutimit të investimeve për zhvillimin e parkut, vlerësimin e ndikimit social, ekonomik, mjedisor e strategjik të projektit, dhe strukturën organizative të menaxhimit.

“Shoqëria” është personi juridik në formën e shoqërisë aksionare e emërtuar si DURANA Tech Park S.H.A, themeluar sipas këtij Statuti nga aksioneri i vetëm AIC dhe e regjistruar në Regjistrin Tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), sipas Legjislacionit të Zbatueshëm.

“Trualli” është pasuria e paluajtshme shtetërore me nr. 336, me sipërfaqe 140 400 (njëqind e dyzet mijë e katërqind) m<sup>2</sup>, nr. 338/1, me sipërfaqe 40 600 (dyzet mijë e gjashtëqind) m<sup>2</sup>, nr. 318, me sipërfaqe 81 200 (tetëdhjetë e një mijë e dyqind) m<sup>2</sup>, nr. 324/4, me sipërfaqe 139,565.5 m<sup>2</sup>; me nr. 324/2, me sipërfaqe 5,200 m<sup>2</sup>; me nr. 310, me sipërfaqe 108,100 m<sup>2</sup> në zonën kadastrale 3852, me vendndodhje në Xhafzotaj, Bashkia Shijak, në pronësi të Zhvilluesit dhe do të përdoret nga Zhvilluesi për gjithë kohëzgjatjen e kësaj Marrëveshje me qëllim ndërtimin dhe zhvillimin e





Parkut Durana apo çdo pasuri e cila përcaktohet në të ardhmen nga Këshilli i Ministrave në funksion të zhvillimit të parkut;

“**Transferim**”, ka kuptimin e dhënë në Nenin 13.1 të këtij Statuti.

“**Veprimtaritë e Parkut Teknologjik dhe Shkencor “DURANA Tech Park”**”, janë veprimtaritë e lejuara për t’u ushtruar në DURANA Tech Park, sipas pikës 3 të VKM Nr. 185/2024 dhe çdo akt nënligjor tjetër të nxjerrë nga Këshilli i Ministrave në zbatim të ligjit.

“**VKM Nr. 337/2023**” është Vendimi i Këshillit të Ministrave për përcaktimin e procedurave dhe kriterëve të përzgjedhjes së Zhvilluesit të Parqeve Teknologjike dhe Shkencore.

“**VKM Nr. 416/2023**” është Vendimi i Këshillit të Ministrave për miratimin e kriterëve, rregullave dhe procedurave për përfitim të lehtësirave fiskale nga Zhvilluesit dhe Përdoruesit që operojnë në Parqet Teknologjike dhe Shkencore.

“**VKM Nr. 418/2023**” është Vendimi i Këshillit të Ministrave për miratimin e procedurave për përzgjedhjen e Përdoruesit në Parqet Teknologjike dhe Shkencore.

“**VKM Nr. 185/2024**” është Vendimi i Këshillit të Ministrave për kalimin nga Radiotelevizioni Shqiptar në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, të pasurive të paluajtshme shtetërore nr. 336, Nr. 338/1, Nr. 318, në Zonën Kadastrale 3852, Xhafzotaj, Bashkia Durrës, dhe miratimin e hapjes së Parkut Teknologjik dhe shkencor “DURANA Tech Park”.

“**VKM nr. 13, datë 09.01.2025**” është Vendimi i Këshillit të Ministrave për transferimin në pronësi të Korporatës së Investimeve Shqiptare të pasurive të paluajtshme shtetërore nr. 336, nr. 338/1, nr. 318, nr. 324/4, nr. 324/2, nr. 310, në zonën kadastrale 3852, Xhafzotaj, Bashkia Shijak, dhe për disa ndryshime në Vendimin nr.185, datë 27.3.2024, të Këshillit të Ministrave “Për kalimin nga Radiotelevizioni Shqiptar në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, të pasurive të paluajtshme shtetërore nr. 336, nr. 338/1, nr. 318, në zonën kadastrale 3852, Xhafzotaj, Bashkia Durrës, dhe miratimin e hapjes së parkut teknologjik dhe shkencor “Durana Tech Park”,

“**Zhvilluesi i Parkut Durana**” ka kuptimin e dhënë në VKM Nr. 185/2024 dhe kuptimin e Durana tech park sha , për detyrat që i delegohen asaj pas dates së regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.

## **Neni 2** **Interpretimi**

2.1 Për sa kohë që konteksti i këtij Statuti, nuk përcakton ndryshe:

a) Fjalët e çdo gjinie përfshijnë gjininë e njëra tjetrës;

- b) Fjalët e përdorura në numrin njëjës ose shumës gjithashtu përfshijnë numrin shumës ose njëjës, përkatësisht, përveç kur përjashtohet shprehimisht;
- c) Referencat ndaj çdo miratimi përfshijnë çdo ndryshim ose rimiratim dhe çdo rregull ose rregullore, të bërë sipas atij miratimi;
- d) Kurdoherë që ky Statut i referohet një numri "ditësh", ky numër do t'u referohet ditëve kalendarike, nëse ditët e punës nuk specifikohen;
- dh) çdo referencë ndajnjë "muaji" ose "viti" do të interpretohet si referencë ndaj një muaji ose viti kalendari;
- e) në rast të ndonjë mospajtueshmërie midis ndonjë fjale me gërma kapitale, termi të përkufizuar, fraze ose shkurtime të përcaktuar në nenin 1 dhe çdo dispozite, fjale, termi, fraze ose shkurtime me gërma kapitale të përcaktuar në ndonjë aneks, shtojcë ose bashkëlidhje, kuptimi i përcaktuar në atë aneks, shtojcë ose bashkëlidhje do të ketë përparësi mbi kuptimin e përcaktuar në nenin 1, për sa kohë që konteksti i këtij Statuti nuk e kërkon ndryshe.

### **Neni 3 Shoqëria**

3.1 Emri i Shoqërisë është "DURANA TECH PARK" SHA, e pasuar në mënyrë të pandashme nga shkurtime "SHA", që përfaqëson formën e saj ligjore, ne vijim referuar si "**Shoqëria**".

1.2 Shoqëria është një person juridik shqiptar që ka formën ligjore të shoqërisë aksionare me ofertë private, sipas parashikimeve të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar.

1.3 Aksionari i Shoqërisë gëzon përgjegjësi të kufizuar deri në kufirin e kontributit të tij në kapitalin e Shoqërisë, të përfaqësuar nga aksionet.

1.4 Në të gjitha dokumentat, faturat, reklamat, dhe publikimet e lëshuara nga Shoqëria, pavarësisht mjetit të trasmetimit, emri i Shoqërisë do të paraprihet, ose do të ndiqet nga fjalët si në vijim:

- a. fjalët "Shoqëri Aksionare" ose "SHA"
- b. numri i saj unik i identifikimit (NUIS)
- c. selia e saj
- d. fakti nëse Shoqëria është në likuidim, nëse është rasti.

### **Neni 4 Selia**

4.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rr. Ibrahim Rugova 5, Sky Tower 7/1, Tiranë.

4.2 Shoqëria e ushtron veprimtarinë e saj brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Ajo mund të hapë zyra, filiale, agjenci ose të ofrojë shërbime në gjithë territorin e Shqipërisë, nëse Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve merr një vendim për këtë qëllim.

## **Neni 5** **Objekti**

5.1 Shoqëria ka objekt veprimtarie të saj menaxhimin, ndërtimin, administrimin, financimin, operimin, funksionimin dhe mbarëvajtjen e Parkut Teknologjik dhe Shkencor DURANA Tech Park, sipas planit të detajuar të miratuar në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm si dhe zhvillimin e Parkut për ato funksione të cilat janë të transferueshme nga Zhvilluesi i autorizuar, të cilat mund të ushtrohen nëpërmjet stafit të tij apo nëpërmjet subjekteve të treta të përgjedhura përmes procedurave konkurruese, në rastet kur autorizohet nga Zhvilluesi.

5.2 Për qëllim të ushtrimit të veprimtarisë së saj, Shoqëria do të zhvillojë aktivitetet si më poshtë vijon:

- a. projektimin, zhvillimin dhe shërbimet e menaxhimit të projektit duke siguruar infrastrukturë virtuale dhe fizike me objekte moderne të përshtatshme për përdoruesit e parkut qofshin këto kompanitë e teknologjisë, startup apo institucione arsimore.
- b. prokurimin/konkurrimin, përzgjedhjen, kontraktimin dhe financimin/partneritetin me qëllim ndërtimin /zhvillimin e parkut, përzgjedhjen e përdoruesve virtual apo në infrastrukturën fizike të parkut apo cdo lloj shërbimi /veprimi të nevojshëm për mirë funksionimin e parkut.
- c. hartimin e një strategjie të përshtatshme për funksionimin/marketingun për të tërhequr kompanitë kryesore të teknologjisë, startup-et dhe institucionet kërkimore/ arsimore.
- d. sigurimin e një mbështetjeje të plotë IT, duke përfshirë infrastrukturën teknologjike të nevojshme virtuale apo fizike.
- e. mbikëqyrja e operacioneve të përditshme për të siguruar funksionimin efikas të parkut;
- f. Organizimin e aktiviteteve dhe ngjarjeve për të nxitur inovacionin, bashkëpunimin dhe zhvillimin e komunitetit brenda parkut.
- g. Formimi i partneriteteve strategjike me universitete, qendra kërkimore dhe organizata të tjera vendase dhe të huaja për të promovuar bashkëpunimin dhe zhvillimin teknologjik.
- h. Ofrimin e shërbimeve mbështetëse për përdoruesit, si konsulenca biznesi, trajnimi dhe asistenca teknike.
- i. Sigurimi i përputhshmërisë me të gjitha kërkesat ligjore financiare dhe rregullatore.
- j. Lidhja e kontratave përkatëse me përdoruesit





- k. Administrimi dhe përditësimi i "Listës së përdoruesve"
- l. Çdo veprim tjetër që mund të parashikohet në ligjin e zbatueshëm për shoqëritë tregtare apo për parqet teknologjike dhe shkencore për entitet në cilësinë e zhvilluesit dhe menaxhuesit të një parku teknologjik dhe shkencor.
- m. Çdo veprimtari tjetër të përcaktuar në Marrëveshjen midis MEKI dhe Zhvilluesit të Parkut si dhe në Planin e detajuar të Zhvillimit të miratuar sipas legjislacionit në fuqi.
- n. Si dhe çdo veprimtari tjetër të lejuar nga ligji dhe në funksion të qëllimit dhe objektivave të Shoqërisë.

5.3 Në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm dhe licencat e Shoqërisë të lëshuara nga autoritetet kompetente, Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi, apo që ndërvaret ose lidhet me aktivitetet e renditura më sipër.

5.4 Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet dhe/ose shtohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve pas propozimit të Këshillit Mbikqyrës.

5.5 Shoqëria, me qëllim ushtrimin e veprimtarisë së saj, do të bashkëpunojë me persona fizikë dhe/ose juridikë që operojnë në Shqipëri dhe/ose jashtë saj.

#### **Neni 6 Kohëzgjatja e Shoqërisë**

6.1 Shoqëria fiton personalitet juridik dhe fillon veprimtarinë e saj në datën e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) sipas parashikimeve të Ligjit 9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar.

6.2 Kohëzgjatja e Shoqërisë vijon për një periudhë të pacaktuar, ose deri në mbylljen e Shoqërisë sipas parashikimeve në këtë Statut, akteve të nxjerra në bazë të tij, ose siç parashikohet ndryshe nga Legjislacioni i Zbatueshëm.

#### **Neni 7 Aksionarët**

7.1 Aksionari i vetëm i Shoqërisë është Korporata e Investimeve Shqiptare (e njohur edhe me akronimin në anglisht (Albanian Investment Corporation AIC), sipas parashikimeve të bëra në Hyrje të këtij Statuti.

7.2 Në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm dhe këtë Statut, Aksioner i Shoqërisë mund të bëhet çdo person juridik dhe/ose fizik, vendas apo i huaj, me kusht që transferimi i aksioneve t'i jetë nënshtruar paraprakisht të Drejtës së Parablerjes nga Aksionarët ekzistues dhe Asambleja e Përgjithshme të ketë miratuar transferimin.



## **Neni 8** **Shpenzimet e Themelimit**

8.1 Aksionari do të themelojë, organizojë, regjistrojë dhe licensojë Shoqërinë, me qëllim ushtrimin e aktivitetit të Shoqërisë. Aksionari do të nënshkruajë dokumente të tjera dhe ndër marrë veprime të tjera që mund të jenë të nevojshme ose të dobishme për të vënë në zbatim parashikimet e këtij Statuti dhe Legjislacionit të Zbatueshëm. Aksionari duhet të bëjë përpjekjet më të mira të arsyeshme për promovimin e Shoqërisë dhe bie dakord që të veprojë nën frymën e bashkëpunimit, mirëbesimit dhe sigurisë reciproke.

8.2 Aksionari AIC, duke filluar nga Data e Themelimit, do të mundësojë të gjitha shpenzimet e nevojshme për krijimin dhe regjistrimin e Shoqërisë, referuar legjislacionit në fuqi.

## **KREU II** **KAPITALI I SHOQËRISË**

### **Neni 9** **Kontributi në Kapitalin e Shoqërisë**

9.1 Kapitali i shoqërisë është 50.000.000 (pesëdhjetë milion) lekë, i ndarë në 100 aksione, secila me vlerë nominale prej 500.000 (pesëqind mijë) lekë, të zotëruara 100% nga Aksionari i vetëm.

9.2 Kapitali fillestar do të shlyhet në përputhje me legjislacionin në fuqi, nga si më poshtë vijon:

**-Korporata e Investimeve Shqiptare SHA, (AIC)** shoqëri tregtare me statusin shoqëri aksionare e të drejtës shqiptare, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) më 17.07.2020, me NUIS M01917011D dhe seli në adresën Rr. Ibrahim Rugova 5, Sky Tower 7/1, Tiranë – Shqipëri;

9.3 Në momentin e themelimit, bazuar dhe në kontributin e sipërpërmendur, AIC zotëron 100% të kapitalit të shoqërisë (këtej e tutje referuar si "**Aksionari vetëm**"). AIC kontribuon në kapitalin e shoqërisë përmes:

- a. Të drejtave të lidhura me vlerën e territorit/truallit të Parkut që vihet në dispozicion për zhvillim dhe menaxhim, të përcaktuara ose që do të përcaktohen në dispozitat e këtij statuti apo Kontratës së Menaxhimit.
- b. Të drejtat e lidhura me vlerën e investimeve të qeverisë shqiptare/Zhvilluesit për të siguruar infrastrukturën e nevojshme si: rrugët, energjia elektrike, fibraoptike, shërbimet utilitare, etj. të përcaktuara ose që do të përcaktohen në dispozitat e Kontratës së Menaxhimit/Administrimit.

- c. Të drejtat e lidhura me vlerën e të drejta vetë aksesit për të hyrë dhe marrë pjesë si partner biznesi në Projekt.
- d. Të drejtat e lidhura me vlerën e përjashtimeve nga taksat dhe përfitimeve ose lehtësirave të tjera që Shoqëria do të përfitojë nga qeveria shqiptare, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në lidhje me statusin e Shoqërisë si zhvillues i deleguar i Projektit.
- e. Të drejtat e lidhuara me vlerën e funksioneve të deleguara nga Zhvilluesi i Parkut me qëllim mirëmenaxhimin e Parkut Durana.
- f. Të drejtat e lidhura me vlerën e "IP rights" të përdoruesve sipas parashikimeve të kontratave përkatëse me Përdoruesit e Parkut.
- g. Çdo e drejtë tjetër e akorduar me shkrim nga asambleja e aksionerëve.

#### **Neni 10** **Kontributi në natyrë**

10.1 Në rast se Aksioneri do të shlyejë kontributin e tij në Kapitalin e Shoqërisë në natyrë, këto kontribute duhet të vlerësohen përpara regjistrimit të Shoqërisë nga një apo disa ekspertë të caktuar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

10.2 Në rast të Kontributit në natyrë, Aksioneri përkatës duhet të shlyejë plotësisht kontributin përpara regjistrimit të Shoqërisë.

#### **Neni 11** **Aksionet e Shoqërisë**

11.1 Të gjitha aksionet e Shoqërisë që emëtohen në Datën e Themelimit, janë aksione të zakonshme.

11.2 Në rast se përgjatë aktivitetit të Shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve merr vendim për emetimin e aksioneve me përparësi, vendimi duhet të përcaktojë në mënyrë shteruese përparësitë përkatëse.

11.3 Pavarësisht ndonjë dispozite tjetër që mund të bjerë në kundërshtim me savijon, nëse në të ardhmen do ndryshojë numri i aksionarëve, interesi në përqindje i AIC, të drejtat ekonomike, të shpërndarjes së fitimit, votimit ose të drejtat e tjera të saj, do të mbeten të pandryshueshme deri në një vlerë minimale prej 25% të kapitalit të përgjithshëm të shoqërisë, dhe nuk do të reduktohen ose pakësohen nga asnjë kontribut në përqindjen e kapitalit të Shoqërisë, kontribut në Natyrë, emetimi i aksioneve të tjera, ndarja e aksioneve, bashkimeve me përthithje, riorganizimeve, pranimeve të Aksionarëve të rinj sipas termave të këtij Statuti, ose çdo arsyeje tjetër, përsa kohë që Shoqëria (ose pasardhësja e saj) ekziston dhe AIC (ose pasardhësja e saj) vijon të jetë Aksionar.





11.4 Në rast se Shoqëria emeton aksione me vlerë të çfarëdolloji, atëherë Shoqëria do të rrisë numrin e aksioneve në pronësi të AIC, në mënyrë të tillë që pronësia proporcionale e AIC mbi aksionet e Shoqërisë të mos zvogëlohet.

## **Neni 12** **Regjistri i Aksioneve**

12.1 Administratori do të mbajë Regjistrin e Aksioneve, me qëllim pasqyrimin e çdo të drejte të aksionarëve apo palëve të treta mbi aksionet e Shoqërisë ("*Regjistri i Aksioneve*"). Regjistri i Aksioneve duhet të përmbajë të dhënat e kërkuara nga Legjislacioni i Zbatueshëm.

12.2 Aksionarët e regjistruar në Regjistrin e Aksioneve prezumohen të jenë aksionarë kundrejt Shoqërisë dhe të tretëve. Pronësia mbi aksionet dhe çdo e drejtë e lidhur me to, nuk mund të ushtrohet kundrejt Shoqërisë apo palëve të treta, përpara regjistrimit të kesaj pronësie në Regjistrin e Aksioneve të mbajtur nga Shoqëria.

12.3 Secili nga Aksionarët gëzon të drejtën, nëpërmjet paraqitjes së një kërkesë me shkrim, për t'u pajisur me ekstraktin e Regjistrit të Aksioneve që mbanvulën e Shoqërisë.

12.4 Administratori duhet të raportojë, brenda afateve të kërkuara, çdo ndryshim të të dhënave të regjistruara në Regjistrin e Aksioneve të Shoqërisë, në përputhje me kërkesat e Legjislacionit të Zbatueshëm.

## **Neni 13** **Kufizimi i transferimit të Aksioneve për aksionarë të ndryshëm nga AIC**

13.1 Aksionari i Shoqërisë i ndryshëm nga AIC mund të shesë, transferojë, caktojë, ngarkojë me Barrë ose tjetërsojë drejtpërdrejt ose tërthorazi aksionet e veta në Shoqëri, ose pjesë të tyre, qoftë për pagesë në para apo në natyrë, ose një ndërthurje të të dyjave, ose pa pagesë, si dhe lidh marrëveshje, opsione apo ujdë tjetër referuar transferimit, caktimit, ngarkimit apo tjetërsimit të plotë ose të pjesshëm të aksioneve të veta, vetëm nëse plotësohen kumulativisht tre kushtet si më poshtë vijon:

- a. Nga ana e Aksionerit AIC është ushtruar e Drejta e Parablerjes për Aksionin / Aksionet apo atë pjesë të tij që do të transferohet, në rast se në të ardhmen do jetë më shumë se 1 aksioner.
- b. Nga ana e aksionerëve të tjerë të ndryshëm nga AIC, është ushtruar e Drejta e Parablerjes për Aksionin / Aksionet apo atë pjesë të tij që do të transferohet, në rast se në të ardhmen do jetë më shumë se 1 aksioner.
- c. Transferimi është miratuar me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve.

13.2 Në rast se Procedura e të Drejtës së Parablerjes rezulton efektive, kushti i përcaktuar në Nenin 13.1, pika c, nuk është i nevojshëm për t'u përmbushur. Në rast se Procedura e të Drejtës së



Parablerjes rezulton jo-efektive, plotësimi i kushtit të përcaktuar në Nenin 13.1, pika c, është përcaktues për realizimin e Transferimit.

13.3 Në rast të Procedurës së Parablerjes jo efektive dhe mosplotësim të kushtit të parashikuar në Nenin 13.1, pika c më sipër, Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve mund të ndalojë transferimin nëpërmjet një vendimi për mosdhënien e miratimit për transferim deri në 6 (gjashtë) muaj kalendarikë nga vendimmarrja e parë për këtë qëllim.

13.4 Nëse edhe pas kalimit të afatit 6-mujor sipas përcaktimit të Nenit 13.3, Aksionari që synon të ushtrojë të drejtën e Transferimit, paraqet po të njëjtën kërkesë, Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve nuk mund ta kufizojë dhe Transferimi do të lejohet të kryhet.

#### **Neni 14** **Procedura e të Drejtës së Parablerjes**

14.1 Aksionari Jo-Shitës, në rastin kur Shoqëria do të ketë më shumë se 1 aksionar, brenda një periudhe prej 20 (njëzet) Ditësh Pune pas Njoftimit të Shitjes, do t'i dërgojë Aksionarit Shitës një njoftim me shkrim, në të cilin deklaron se dëshiron të blejë Aksionin e Ofruar sipas Kushteve të Ofertës, ose refuzon të blejë Aksionin e Ofruar ("Përgjigje"). Nëse Aksionari Jo-Shitës nuk dërgon Përgjigje brenda periudhës së përcaktuar më sipër, konsiderohet se Aksionari Jo-shitës ka refuzuar ta blejë Aksionin e Ofruar.

14.2 Me marrjen e Përgjigjes në të cilën deklarohet se Aksionari Jo-Shitës dëshiron të blejë Aksionin e Ofruar sipas Kushteve të Ofertës, Aksionari Shitës është i detyruar ta shesë në mënyrë të pakushtëzuar dhe Aksionari Jo-Shitës është i detyruar ta blejë në mënyrë të pakushtëzuar Aksionin e Ofruar sipas Kushteve të Ofertës.

14.3 Procedura e shitjes së Aksionit të Ofruar për Aksionarin Jo-Shitës do të kryhet sipas rendit të mëposhtëm:

- a. Aksionari Jo-Shitës AIC apo aksioneri tjetër Jo shitës, pasi e drejta e aksionerit AIC është shteruar, do të depozitojë sigurimin e përshtatshëm të pagesës sipas Kushteve të Ofertës, sipasrastit.
- b. Aksionarët do të sigurohen që, duke shmangur vonesa jo të nevojshme, të gjitha miratimet që mund të kërkohen për të kryer blerjen e Aksionit të Ofruar, do të merren nga Autoriteti i Konkurrencës dhe do të jenë përfundimtare dhe jo të apelueshme. Shpenzimet për procedurat e marrjes së miratimit nga Autoriteti i Konkurrencës do të mbulohen nga Aksionari Jo-Shitës.
- c. Aksionari Jo-Shitës AIC/ Jo AIC dhe Aksionari Shitës do të nënshkruajnë Aktin e Transferimit lidhur me Aksionin e Ofruar dhe do të vërtetojnë nënshkrimet e tyre në mënyrë të rregullt.





- d. Aksionari Shitës do të dorëzojë të gjitha miratimet ose dokumentet e tilla (*nëse ka*), sipas nevojës, për të dhënë prova për titullin e Aksionit të Ofruar dhe kapacitetin e Aksionarit Shitës për të shitur dhe transferuar të njëjtin.

14.4 Në rast të një Përgjigje negative nga Aksioneri Jo-Shitës AIC/jo AIC, ose refuzimi të heshtur nga Aksionari Jo-Shitës për të blerë Aksionin e Ofruar, Aksionari Shitës mund ta përfundojë Transaksionin e Propozuar në përputhje me Njoftimin e Shitjes brenda 20 (*njëzet*) Ditëve Pune (*nëse nuk kërkohet miratim i nga Autoriteti i Konkurrencës për Transaksionin e Propozuar*), ose brenda 5 (*pesë*) muajve (*nëse kërkohet miratimi i përqendrimeve për Transaksionin e Propozuar*). Nëse Transaksioni i Propozuar nuk ka përfunduar brenda periudhës së përcaktuar në këtë Nen, çdo përpjekje e Aksionarit Shitës për të shitur aksionin e tij do të konsiderohet Transferim i ri dhe i nënshtrohet procedurës së përcaktuar në Nenin 13.

### Neni 15

#### Procedura e Transferimit për aksionar të ndryshëm nga AIC

15.1 Në përputhje me parashikimet e Nenit 13, për qëllim të Transferimit, Aksionari Shitës e lajmëron me shkrim Shoqërinë, duke përcaktuar qëllimin për të transferuar aksionet që ka në Shoqëri (*"Aksionet e Ofruara"*). Njoftimi (*"Njoftimi i Shitjes"*) përcakton Aksionet e Ofruara, çmimin e Transferimit dhe kushtet e tjera sipas së cilave Aksionet e Ofruara propozohen të transferohen në favor të një personi tjetër (*"Blerësi"*), identitetin e Blerësit dhe datën kur Transaksioni i Propozuar pritet të përfundojë (*"Kushtet e Ofertës"*).

15.2 Jo më vonë se 5 (*pesë*) ditë kalendarike nga data e marrjes së njoftimit sipas pikës 15.1 më sipër, Asambleja zhvillon Mbledhjen për të shqyrtuar Transferimin e Aksionit, Kushtet e Ofertës dhe Blerësin.

15.3 Nëse pas shqyrtimit në Mbledhje, Asambleja nuk e miraton Transaksionin e Propozuar, duhet të paraqesë raportin përkatës me shkrim i cili përcakton arsyet e refuzimit. Në çdo rast, për qëllim të këtij neni, arsye të vlefshme refuzimi do të konsiderohen vetëm shkaqet që lidhen me:

- a. Gjendjen financiare të Blerësit.
- b. Përputhshmërinë ligjore të Blerësit.
- c. Përputhshmërinë ligjore të Blerësit individ ose individëve anëtarë të organeve drejtuese të Blerësit person juridik.

15.4 Në rast refuzimi, sipas pikës 15.3 më sipër, Asambleja do të caktojë me vendim një Blerës alternativ, nëse ka, i cili do t'i blejë aksionet e Aksionarit shitës sipas termave dhe kushteve që nuk janë më pak të favorshme se ato të parashtruara në Njoftimin e Shitjes. Në rast mosmarrëveshesh midis Aksionerëve në lidhje me gjendjen financiare të Blerësit të propozuar, një prej katër firmave të mëdha të kontabilitetit (*caktuar bashkërisht nga Aksionerët dhe paguar nga Aksionari Shitës*)

do të konfirmojë nëse entiteti ka gjendje financiare të të mjaftueshme për të ushtruar kompetencat e Aksionarit të Shoqërisë.

15.5 Në rast transferimi të Aksionit nëpërmjet nënshkrimit të Kontratës përkatëse, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi Aksionin, sidhekushtet e tjera të kalimit, përfshi momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata do të hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përbën kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e saj.

15.6 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga Legjislacioni I Zbatueshëm, ky Statut apo kur palët bien dakord në kontratë, vlefshmëria e kalimit të titullit të pronësisë mbi aksionet nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshi këtu formalitetet e regjistrimit a publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit.

### **KREU III ORGANET E SHOQËRISË**

#### **Neni 16 Sistemi i drejtimit të Shoqërisë**

16.1 Vendimmarrja dhe administrimi i Shoqërisë do të realizohet nëpërmjet sistemit me 2 (dy) nivele drejtimi, sipas Legjislacionit të zbatueshëm për shoqëritë tregtare.

16.2 Në përputhje me pikën 16.1 më sipër, organet drejtuese të Shoqërisë janë:

- a. Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve
- b. Këshilli Mbikëqyrës
- c. Administratori/ët
- d. Bordi Këshillimor i Përdoruesve të Parkut dhe Bordi Këshillimor i Partnerëve Publik të parkut

16.3 “Komiteti për partneritet në zonat ekonomike dhe parqet teknologjike” (KPZET) pranë AIC do të shërbejë si Këshillues Teknik i organeve drejtuese të Shoqërisë për çështje të lidhura me hartimin dhe shqyrtimin e dokumentacioni teknik përgjatë aktivitetit të shoqërisë, hapjes dhe vlerësimit të procedurave konkurruese si dhe marrëdhënieve të Menaxhuesit me Zhvilluesin.

16.4 Përveç KPZET, shoqëria Durana Tech Park sh.a përgjatë tre viteve të para nga data e regjistrimit të saj, ka mundësinë të marrë nga grupi i ekspertëve të AIC-së, ekspert të jashtëm që asistojnë shoqërinë në çështje specifike që lindin gjatë zhvillimit të veprimtarisë së saj.

16.5 Njësia e monitorimit të Operimit/Ndërtimit të parkut parashikuar në Marrëveshjen e Zhvilluesit me MEKI ka funksion monitorues/kontrollues në veprimtarinë e punës së shoqërisë.



**Neni 17**  
**Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve**

17.1 Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë dhe vendimet e saj janë të detyrueshme për çdo organ të Shoqërisë, ku të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme ushtrohen nga aksionari i vetëm.

17.2 Mbledhja e Asamblesë, drejtohet nga Kryetari i cili përzgjidhet në mbledhjen e parë të Asamblesë nga të gjithë aksionarët, në rast se do jenë më shumë se 1 aksionar.

17.3 AIC, si aksionari vetëm, përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme të Aksionarëve nga Drejtori Ekzekutivi AIC-së.

**Neni 18**  
**Njoftimi dhe Vendi i Mbledhjes**

18.1 Mbledhja e Asamblesë mund të thirret nga Këshilli Mbikëqyrës, Administratori ose nga çdo Aksionari që zotëron përqindjen e nevojshme sipas Legjislacionit të Zbatueshëm.

18.2 Të gjitha njoftimet për thirrjen e Mbledhjeve të Asamblesë kryhen sipas parashikimeve të Legjislacionit të Zbatueshëm, përmes njoftimit të dërguar me letër rekomande (*postë të gjurmueshme*) dhe njëkohësisht të dërguar me faks ose korrespondencë elektronike (*e-mail*), me kërkesë konfirmimi. Njoftimi i Mbledhjes duhet të përmbajë orën, vendin, rendin e ditës, vendimet e propozuara me materialin mbështetës përkatës, si dhe kërkesat për kuorimin e nevojshëm për mbledhjen e propozuar.

18.3 Mbledhja e Asamblesë thirret detyrimisht njëherë në vit dhe jo me vonë se fundi i 6- mujorit të parë, pas mbylljes së vitit financiar.

18.4 Mbledhjet e Asamblesë mbahen në selinë e Shoqërisë, ose virtualisht nëpërmjet mjeteve telefonike/elektronike ose në çdo vend tjetër të propozuar dhe të dakordësuar bashkërisht nga Aksionarët.

18.5 Mbledhjet e Asamblesë mund të zhvillohen me anë të konferencave telefonike, platformave video ose mjeteve të ngjashme të komunikimit për aq kohë sa të gjithë Personat pjesëmarrës në mbledhje, konfirmojnë komunikimin efikas në mbledhje. Pjesëmarrja në Mbledhjen e Asamblesë nëpërmjet konferencave telefonike, platformave video ose mjeteve të ngjashme të komunikimit, në përputhje me fjalinë pararendëse, do të konsiderohet si prani fizike në këto mbledhje.

**Neni 19**  
**Përfaqësimi përmes autorizimit**

19.1 Një Aksionar mund të përfaqësohet në Mbledhjen e Asamblesë nga një person tjetër i autorizuar. Autorizimi jepet me shkrim vetëm për një Mbledhje Asambleje dhe do të konsiderohet se përfshin vetëm mbledhjet e mëtejshme që kanë të njëjtin rend dite.



19.2 Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të aksionarit të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të aksionarit përfaqësuar.

19.3 Në asnjë rast, Administratori dhe/ose anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk mund të veprojnë si përfaqësues të aksionarëve në Mbledhjen e Asamblesë së përgjithshme.

## **Neni 20** **Kuorumi**

20.1 Në funksion të vlefshmërisë së Mbledhjes së Asamblesë, kuorumi i nevojshëm është: pjesëmarrja ose përfaqësimi e Aksionarëve që zotërojnë 50%+1 (*pesëdhjetë për qind plus një*) të totalit të aksioneve.

20.2 Në rast se Mbledhja Asamblesë sipas kuoromit të parashikuar në pikën 20.1, nuk mund të realizohet, Mbledhja e radhës do të mbahet jo më herët se 10 (*dhjetë*) ditë kalendarik edhe jo më vonë se 30 (*tridhjetë*) ditë kalendarike nga data në të cilën duhej të ishte mbajtur Mbledhja fillestare. Në funksion të vlefshmërisë së kësaj Mbledhje pasuese, kuorumi i nevojshëm është: pjesëmarrja ose përfaqësimi e Aksionarëve që zotërojnë jo më pak se 30% (*tridhjetë për qind*) të totalit të aksioneve.

## **Neni 21** **Vendimmarrja e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve**

21.1 Vendimet e Asamblesë konsiderohen të vlefshme nëse miratohen nga jo më pak se 50% + 1 (*pesëdhjetë për qind plus një*) e votave të Aksionarëve pjesëmarrës në Mbledhje.

21.2 Në çdo rast, Vendimet e Asamblesë referuar çështjeve si më poshtë vijon, do të konsiderohen të vlefshme nëse miratohen nga jo më pak se 75% (*shtatëdhjetë e pesë për qind*) e votave të Aksionarëve pjesëmarrës në Mbledhje:

- a. Vendimi për të ndryshuar objektin e veprimtarisë.
- b. Miratimi ose ndryshimi i Buxhetit vjetor.
- c. Miratimi i ndryshimit të selisë së regjistruar.
- d. Miratimi i ndryshimit të formës ligjore të Shoqërisë.
- e. Miratimi për zmadhimin dhe/ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë.
- f. Miratimi i pagesave të shpërndarjes së fitimeve dhe/ose dividendëve, mbulimit të humbjeve ose i ndryshimeve të politikave lidhur me shpërndarjet.





- g. Emetimi i instrumenteve shtesë në Shoqëri (*duke përfshirë opsionet, garancitë dhe të drejta të tjera për të marrë pjesë në letrat me vlerë të Shoqërisë*), qoftë i natyrës së aksioneve, borxhit ose një hibrid i të dyve.
- h. Transferimi i aksioneve sipas dispozitave të parashikuara në këtë Statut (*Transferimi i Aksioneve*) dhe termave dhe kushteve të investimit nga një aksionar i ri.
- i. Emërimi dhe lirimi i i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës.
- j. Kuotimi ose heqja e Shoqërisë nga bursa.
- k. Vendime lidhur me bashkimin me përthithje, shkëputjen, ndarjen, veçimin, zgjidhjen, shitjen, blerjen ose ristrukturimin e Shoqërisë, ose me shitjen e të gjitha, ose thujse të gjitha, aktiveve të veta ose shitja apo përthithja (*përmes një ose disa transaksioneve*) e aktiveve ose bizneseve të tjera të Shoqërisë.
- l. Vendime lidhur me përfshirjen në sipërmarrje të përbashkëta ose partneritete të çdolloj forme, duke përfshirë partneritetet e heshtura ose çdo marrëveshje që i jep palës tjetër pjesë në fitimin e Shoqërisë, ose të drejtën e shpërblimit në varësi të shumës së fitimit.
- m. Vendimet për likuidimin, mbylljen dhe aplikimin për hapjen e procedurës së falimentimit të Shoqërisë.
- n. Miratimi i emërimit dhe largimit të audituesve të Shoqërisë sipas propozimit të Këshillit Mbikëqyrës.
- o. Ndryshimet e Statutit ose dokumenteve të tjera rregullatore të Shoqërisë.
- p. Miratimet për themelimin e shoqërive të reja ose themelimit të shoqërive të tjera të kontrolluara, si dhe dokumenteve përkatës për themelimin dhe regjistrimin e tyre (*përfshirë ndryshimet që mund të pësojnë*).
- q. Miratimi i një pengu ose barrësimi tjetër të aksioneve ose një pjese të aksioneve të një Aksionari.
- r. Miratimi i transferimit të aksioneve ose një pjesë të aksioneve në zotërim të Aksionarëve ekzistues.
- s. Miratimi i ndryshimit në periudhën kontabël dhe politikën e kontabilitetit të Shoqërisë.
- t. Me përjashtim të parashikimit dhe përcaktimit konkretisht në Buxhet, dhënia e huave, mbartja ose miratimi i dispozitave për Borxh ose marrëveshje të lidhura më të, ose pagesat paraprake për, ose garantimet e detyrimeve të, ndonjë Personi nga Shoqëria (*me përjashtim të Shoqërive të Kontrolluara të Shoqërisë*).
- u. Fillimi i proceseve gjyqësore apo zgjidhja me mirëkuptim e çështjeve apo mosmarrëveshjeve thelbësore, jashtë veprimtarisë së zakonshme të Shoqërisë.



- v. Miratimi i shitjes apo disponimit të aktiveve të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% (pesë për qind) të aseteve të Shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- w. Miratimi i blerjes nga një aksionar, i pasurive që kanë vlerë më të lartë se 5% (pesë për qind) të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

21.3 Për të shmangur çdo paqartësieventuale, kuorumi i vlefshmërisë së vendimmarrjes sipas përcaktimit të pikës 21.1, aplikohet për çdo vendim i cili nuk parashikohet në pikën 21.2.

21.4 Vendimet e Asamblesë duhet të jenë në gjuhën shqipe dhe nëse pjesë e mbledhjes përkatëse të Asamblesë ku është marrë vendimi, janë aksionarë ose përfaqësues të tyre me shtetësi jo shqiptare, vendimet do të përkthehen edhe në gjuhën angleze. Në këtë rast, aksionarët ose përfaqësues të tyre do të nënshkruajnë vendimin në të dyja gjuhët. Në rast mospërputhje, varianti në gjuhën shqipe do të prevalojë.

21.5 Nëse Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve përbëhet nga një aksionar i vetëm, do të regjistrohen në një regjistër të vendimeve të gjitha vendimet e marra nga aksionari i vetëm, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare. Të dhënat e regjistrit të vendimeve nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

## Neni 22

### Të drejtat e vetos së AIC

22.1 Në rastet kur shoqëria do të ketë më shumë se 1 aksionar dhe në çdo rast, kur vendimmarrja e Asamblesë së Përgjithshme të aksionarëve nuk do të ketë dakortësi dhe unanimitet për një ose disa nga çështjet si më poshtë listuar, AIC gëzon të drejtën e vetos:

- a. Miratimi dhe ndryshimi i dokumenteve kryesore/themelore të Shoqërisë dhe çdo shoqërie të kontrolluar, Dege dhe/ose Zyre Përfaqësimi të saj, nëse ka.
- b. Ndryshimet në natyrën dhe qëllimin e objektit të veprimtarisë së Shoqërisë, duke përfshirë krijimin, transferimin dhe braktisjen e linjave të biznesit.
- c. Miratimi i dokumentave financiare të Shoqërisë, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:
  - i. miratimin e pasqyrave financiare dhe raport e vetëaudituar, planin e biznesit dhe ndryshimet e tij, buxhetin vjetor dhe çdo ndryshim të tij;
  - ii. miratimin e planeve financiare vjetore ose afatgjata dhe niveleve të borxhit të Shoqërisë, duke përfshirë termat e atij borxhi;
  - iii. adoptimin e çdo ndryshimi të rëndësishëm në politikat kontabël të Shoqërisë
  - iv. çdo dokument ose transaksion tjetër që ndryshe mund të ketë një ndikim material në fitimin e Shoqërisë.

- d. Rritjet/reduktimet e kapitalit të Shoqërisë.
- e. Çdo bashkim ose blerje, shkrije ose ristrukturim të Shoqërisë, duke përfshirë hyrjen në një sipërmarrje të përbashkët, partneritet ose ndonjë marrëveshje tjetër që nuk parashikohet nga plani i biznesit, buxheti ose marrëveshjet që nuk kërkojnë përputhje me rregullat e prokurimit.
- f. Shpërndarja e fitimit dhe/ose dividendëve dhe politikat e lidhura me to.
- g. Miratimi dhe/ose revokimi i likuidimit ose shpërbërjes vullnetare të Shoqërisë, duke përfshirë emërimin dhe/ose shkarkimin e likuidatorëve përkatës dhe dhënien e kompetencave përkatëse atyre.
- h. Emërimi dhe shkarkimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, Administratorit dhe çdo zyrtari tjetër të lartë të Shoqërisë, duke përfshirë përcaktimin e kompetencave të tyre përkatëse (ose çdo ndryshim të tyre) dhe çdo vendim në lidhje me shpërblimin e zyrtarëve të lartë të Shoqërisë.
- i. Miratimi i çdo marrëveshjeje ose transaksioni që nuk parashikohet nga plani i biznesit ose buxheti i miratuar që:
  - i. nuk është brenda kursit të zakonshëm të biznesit dhe të nevojshëm për kryerjen e biznesit të Shoqërisë;
  - ii. tejkalon shumën e kufirit të ulët monetar individualisht ose në total gjatë një viti financiar;
  - iii. sipas kushteve të tij është më e gjatë se 12 muaj ose ndryshe, nuk mund të ndërpritet për arsye të leverdisshmërisë pa pasoja financiare për Shoqërinë me një njoftim paraprak tre mujor për ndërprerje.
- j. Miratimi i çdo ndërmarrjeje të borxhit (përfshirë huatë e aksionarëve) ose dhënia e ndonjë të drejte, detyrimi ose garancie, vlera e të cilave tejkalon vlerën e kufirit të ulët monetar, individualisht ose në total gjatë një viti financiar.
- k. Miratimi i çdo blerjeje ose shitjeje të aseteve materiale ose jomateriale (përfshirë pjesëmarrjet, pasuritë e paluajtshme, pronësinë intelektuale) me një vlerë që tejkalon shumën e përcaktuar si kufiri i ulët monetar, individualisht ose në total gjatë një viti financiar.
- l. Çdo vendim që ka të bëjë me fillimin, përfundimin, heqjen dorë nga ndonjë e drejtë ose ndryshe zgjidhjen e ndonjë procedure ligjore në ndonjë forum kundër ndonjë pale të tretë, përveç procedurave për të cilat vlera e pretenduar, detyrimi ose përfitimi nuk e kalon shumën e përcaktuar si kufiri i ulët monetar, individualisht ose në total gjatë një viti financiar.





- m. Emërimi i auditorëve dhe këshilltarëve të jashtëm ligjorë të Shoqërisë.
- n. Miratimi i Kodit të Etikës së Shoqërisë.
- o. Çdo vendim tjetër të rëndësishëm që mund të parashikohet në Kontratën e Menaxhimit.

22.2 Rregullat e posaçme të zbatimit të këtij neni parashikohen në Rregulloren e Shoqërisë.

### **Neni 23** **Procesverbali i Mbledhjes**

23.1 Administratori do të sigurojë mbajtjen e procesverbalit të Mbledhjes së Asamblesë. Procesverbali duhet të përmbajë: emrin e regjistruar të Shoqërisë, vendin dhe orën e zhvillimit të Mbledhjes, dhe personin që mban procesverbalin, përshkrimin e shkurtër të çdo çështjeje në rendin e ditës, rezultatet e votimit dhe kundërshtimet e Administratorit (*nëse është rasti*).

23.2 Procesverbali do të nënshkruhet nga aksionari i vetëm i Asamblesë dhe mbajtësi i procesverbalit.

23.3 Procesverbali i Mbledhjes së Asamblesë për mbledhjet në të cilat marrin pjesë aksionarë ose përfaqësues të tyre me shtetësi jo shqiptare, do të mbahen në gjuhën angleze. Në çdo rast, nëse në mbledhje do të marrin pjesë vetëm pjesë aksionarë ose përfaqësues të tyre me shtetësi shqiptare, procesverbali do të mbahet vetëm në gjuhën shqipe.

### **Neni 24** **Këshilli Mbikëqyrës**

24.1 Këshilli Mbikëqyrës është organi i Shoqërisë i ngarkuar me mbikëqyrjen e veprimtarisë së Administratorëve sipas politikave të Shoqërisë, neneve të këtij Statuti dhe të Legjislacionit të Zbatueshëm.

24.2 Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë do të përbëhet nga minimumi 3 (tre), maksimumi 5 (pesë) anëtarë ("*Anëtarët*") njëri prej të cilëve shërben si Kryetari i Këshillit ("*Kryetari*"), ndërkohë që shumica prej të cilëve duhet të jenë të pavarur në përputhje me përcaktimet e Legjislacionit të Zbatueshëm.

### **Neni 25** **Emërimi i Anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës**

25.1 Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës do të emërohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve, në përputhje me procedurat ligjore, për një kohëzgjatje prej 3 (tre) vitesh me të drejtë rizgjedhje. Secili Anëtar do të shërbejë deri në momentin e dorëheqjes ose largimit nga detyra në përputhje me parashikimet e këtij Statuti.

25.2 Këshilli i parë Mbikëqyrës do të përbëhet nga 3 anëtarë, të emëruar deri në përfundim të procedurave ligjore dhe emërimit nga Asambleja e përgjithshme. Anëtarët e parë do të jenë:

Z. Julian Adili, shtetas shqiptar, lindur më 03.06.1986, mbajtës i letërnjoftimit nr.033671637, banues në adresën: Rruga "Ali Visha", Tiranë.

Znj. Valentina Kazanxhi, shtetase shqiptare, lindur më 21.09.1976, mbajtëse e letërnjoftimit nr.034946060, banuese në adresën: Rruga "Hysni Gërbolli", Tiranë.

Z. Gledis Shehu, shtetas shqiptar, lindur më 08.03.1984, mbajtës i letërnjoftimit nr. 034140481, banuese në adresën: Rruga e Dibrës , Pll.106/1, Tiranë.

25.3 Anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës do të përzgjidhen individët të cilët përmbushin kriteret si më poshtë vijon:

- a. Nuk kanë qenë të dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale të njohur nga Kodi Penal i RSH;
- b. Zotërojnë të paktën gradën "master shkencor" ose më lart në fushën e ekonomisë, financave, biznesit, drejtësisë, fusha të tjera të ngjashme apo dhe ekspertizë në teknologji.
- c. Kanë shtetësi shqiptare ose të huaj.

25.4 Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës do të emërohen individët, të cilët duhet të jenë të pavarur dhe të ndryshëm nga administratorët e Shoqërisë të cilët lidhin kontratën përkatëse me Shoqërinë. Anëtarë të pavarur të Këshillit Mbikëqyrës vlerësohen personat, të cilët nuk kanë konflikt interesash apo anëtarësie, sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 13 dhe të pikës 3 të nenit 167 të Ligjit Nr.9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.

25.5 Çdo emërim, i bërë në kundërshtim me këto parashikime, është absolutisht i pavlefshëm. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës detyrohen të informojnë menjëherë Shoqërinë, për çdo konflikt interesi, e anëtarësie në Këshillat e çdoshoqërietjetër tregtare.

25.6 Këshilli Mbikëqyrës zgjedh, midis anëtarëve tij, Kryetarin dhe në rastet kur përbërja është prej 5 anëtarëve edhe Zëvendëskryetarin.

25.7 Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës shpërblehen, sipas tarifave të përcaktuara me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve pas marrjes së propozimit nga Këshilli Mbikëqyrës.

25.8 Administratori/ët e Shoqërisë përcaktojnë personin që shërben si Sekretari i Këshillit Mbikëqyrës.

25.9 Ndryshimi i emrave të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës nuk do të përbëjë detyrim për ndryshimin e këtij statuti.



## Neni 26

### Lirimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës

26.1 Anëtari nëpërmjet dorëheqjes, mund të largohet menjëherë dhe kurdoherë për çfarëdo arsyeje nga Këshilli Mbikëqyrës, përmes një njoftimi me shkrim drejtuar Asamblesë dhe Shoqërisë për këtë qëllim. Anëtari i Këshillit që jep dorëheqjen, duke pasur parasysh rrethanat e veprimtarisë së Shoqërisë, është i detyruar të thërrasë Mbledhjen e Asamblesë për emërimin e anëtarit të ri të Këshillit, përpara datës kur dorëheqja të hyjë në fuqi.

26.2 Nëse Asambleja nuk vendos emërimin e anëtarit të ri të Këshillit në datën e përcaktuar në thirrjen e kryernga anëtari i dorëhequr, atëherë administratori apo, në mungesë apo mosveprim të tij, anëtari i dorëhequr, i njofton me shkrim dorëheqjen Qendrës Kombëtare të Biznesit, së bashku me kopjen e thirrjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme me qëllim regjistrimin e largimit të anëtarit, në përputhje me përcaktimet e Legjislacionit të Zbatueshëm.

26.3 Anëtari i ri i emëruar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve, do të mbetet në detyrë deri në përfundimin e mandatit të anëtarit të zëvendësuar.

26.4 Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve mund të shkarkojë, në çdo kohë, me shumicë të thjeshtë votash një anëtar të Këshillit Mbikëqyrës.

## Neni 27

### Mbledhja e Këshillit Mbikëqyrës

27.1 Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës thirren nga Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës kurdoherë që gjykohet e nevojshme për qëllimet e veprimtarisë së Shoqërisë, por jo më pak se dy herë në vit, me nismë të tij ose me kërkesë të Anëtarëve apo të Aksionerëve. Nëse Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës nuk e përmbush këtë kërkesë brenda 30 (tridhjetë) ditësh kalendarike nga kërkesa, çdo Anëtar i Këshillit Mbikëqyrës ka të drejtë ta thërrasë drejtpërdrejt Këshillin Mbikëqyrës.

27.2 Këshilli Mbikëqyrës do të thirret për t'u mbledhur duke dhënë një njoftim paraprak prej të paktën 3 (tre) ditësh kalendarike me postë, faks, email ose telefon, por për secilin rast nevojitet konfirmim. Njoftimet me email ose telefon do të ndiqen nga njoftimet me faks ose postë. Në rast urgjence, periudha e njoftimit mund të shkurtohet deri në 24 (njëzet e katër) orë, me kusht që të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të jenë njoftuar në mënyrë të vlefshme.

27.3 Në rastet e posaçme, Administratori i Shoqërisë ka të drejtën të thërrasë Mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës, kur për mbarëvajtjen e veprimtarisë së Shoqërisë kërkohet vendimmarrje nga Këshilli Mbikëqyrës. Në çdo rast, përthirrjen e Mbledhjes vetë Këshillit nga Administratori, njoftimi nuk duhet të jetë më i vonë se të paktën 24 (njëzet e katër) orë nga data e mbledhjes.

27.4 Nëse Mbledhja e Këshillit Mbikëqyrës sipas pikës 27.2 mësipër nuk arrin të realizohet, Këshilli Mbikëqyrës duhet të marrë masat për zhvillimin e mbledhjes brenda 5 ditëve kalendarike nga data e Mbledhjes që nuk u realizua.

27.5 Koha, vendi dhe rendi i ditës do të caktohen nga Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës, por nëse mbledhja është thirrur nga një Anëtar, vendi dhe rendi i ditës do të caktohen nga Anëtari që e thërret mbledhjen. Në rast urgjence, vendi i mbledhjes do të jetë selia e regjistruar e Shoqërisë.

27.6 Procesverbalet e Mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës do të përmbajnë të njëjtët elementë dhe do t'u aplikohen të njëjtat rregulla, si Procesverbalet e Mbledhjeve të Asamblesë. Në çdo rast, Procesverbalet e Mbledhjes së Këshillit do të nënshkruhen nga çdo Person pjesëmarrës në Mbledhje, si dhe mbajtësi i procesverbalit.

#### **Neni 28**

#### **Mbledhjet me Mjete Elektronike**

28.1 Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës mund të zhvillohen nëpërmjet tele-konferencave, video-platformave ose mënyrave të ngjashme të komunikimit elektronik, për sa kohë që të gjithë Personat që marrin pjesë në këtë mbledhje mund ta konfirmojnë diskutimin efektiv me njëri-tjetrin. Pjesëmarrja në një Mbledhje Këshilli që zhvillohet nëpërmjet tele-konferencës, video-platformës ose mënyrave të ngjashme të komunikimit elektronik, në përputhje me fjalinë pararendëse, do të konsiderohet si prani fizike e Anëtarit në atë mbledhje.

28.2 Në çdo rast, rregullat e përcaktuara në këtë Statut për kuorumin e pjesëmarrjes dhe vendimmarrjes së Këshillit Mbikëqyrës, zbatohen edhe për Mbledhjet e zhvilluara me Mjete Elektronike.

#### **Neni 29**

#### **Kuorumi dhe Votimi**

29.1 Në funksion të vlefshmërisë së Mbledhjes së Këshillit Mbikëqyrës, kuorumi i nevojshëm është pjesëmarrja e më shumë se gjysmës së anëtarëve të Këshillit. Nëse nuk arrihet kuorumi, mbledhja do të shtyhet maksimumi deri në 3 (tre) ditë kalendarike.

29.2 Në funksion të vlefshmërisë së Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës, kuorumi i nevojshëm është votimi nga më shumë se gjysma e anëtarëve pjesëmarrës në Këshill, por në çdo rast jo më pak se 2 (dy) anëtarë. Për çështje që ka barazim votash, vota e kryetarit të Këshillit është përcaktuese.

29.3 Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës gëzojnë të drejtën për të shprehur votën me shkresë, me telefon apo me mjete të tjera të komunikimit elektronik, me përjashtim të rasteve kur një anëtar i Këshillit ka kundërshtime për këtë mënyrë vendimmarrjeje.

29.4 Një anëtar i Këshillit Mbikëqyrës nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës në rastet e parashikuara nga pika 3 e nenit 162 i të Ligjit Nr. 9901/2008 për 'Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare', i ndryshuar.



29.5 Votimi do të koordinohet nga Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës (*ose mbajtësi i procesverbalit në emër të tij*), i cili do t'ua paraqesi Anëtarëve rezultatet e votimit pa vonesa të paarsyeshme por në çdo rast jo më vonë se 5 (pesë) ditë kalendarike.

### Neni 30

#### Vendimmarrja e Këshillit Mbikëqyrës

30.1 Këshilli Mbikëqyrës është përgjegjës në marrjen e vendimeve për Shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:

- a. Emërimi dhe shkarkimi i Administratorit dhe caktimin e shpërblimit për punën e tij/saj, si dhe parimet e përcaktimit të shpërblimit të tij/saj.
- b. Mbikëqyrjen e punës së Administratorit dhe miratimin e raporteve të tij.
- c. Kryerjen e mbikëqyrjeve të brendshme mbi veprimtarinë e Shoqërisë.
- d. Kryerjen e mbikëqyrjes mbi ligjshmërinë e veprimtarisë së Shoqërisë.
- e. Propozimin e politikave të kontabilitetit në Mbledhjen e Asamblesë dhe përcaktimin e riskut të politikave të menaxhimit të Shoqërisë.
- f. Dhënien e urdhrave për audituesit që të hetojnë raportet financiare të Shoqërisë në baza vjetore.
- g. Propozimin në Mbledhjen e Asamblesë për përzgjedhjen e audituesit dhe për rimbursimin e shpërblimit të tij.
- h. Vendime për transaksione me Personat e Lidhur me Shoqërinë, në përputhje me parashikimet Legjislativitet të Zbatueshëm.
- i. Të miratojë marrjen përsipër të detyrimeve me vlerë më të lartë se 5% (*pesë për qind*) të aseteve të Shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare, të certifikuara, nëpërmjet nënshkrimit të huave apo emetimit të obligacioneve apo instrumenteve të tjera të borxhit.
- j. Përveçse kur parashikohet dhe identifikohet specifikisht nga Buxheti, kryerja e shpenzimeve kapitale përtej shumës maksimale të vlerës së kufirit të ulët monetar të përcaktuar nga legjislativiteti i prokurimit për kontratat e punëve /shërbimeve në një Vit Financiar.

30.2 Krahas çështjeve të përcaktuara në pikën 30.1 më sipër, Këshilli Mbikëqyrës jep pëlqimin për vendimet lidhur me të gjitha çështjet që nuk janë rezervuar për vendimarrje në Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve, sipas parashikimeve të Legjislativitetit të Zbatueshëm dhe këtij Statuti.

30.3 Këshilli Mbikëqyrës miraton, ndryshon dhe / ose shfuqizon Rregulloren e Veprimtarisë së Këshillit e cila parashikon rregullat procedurale të ushtrimit të funksioneve të Këshillit. Rregullorja

e Veprimtarisë së Këshillit duhet të miratohet jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj kalendarikë nga plotësimi i Këshillit me të gjithë anëtarët.

### **Neni 31** **Administratori/ët**

31.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë Administrator i cili/të cilët autorizohen të ushtrojë/në së bashku të gjitha kompetencat të parashikuara nga Legjislacioni i Zbatueshëm dhe ky Statut.

31.2 Administratorët e Shoqërisë do të jenë:

Znj. Florensa Kovaçi, shtetase shqiptare, lindur më 15.03.1985, mbajtëse e letërnjoftimit nr.038004263, banuese në adresën: Rezidenca "Kodra e Diellit", Tiranë.

Z. Gjergji Taho, shtetas shqiptar, lindur më 22.08.1982, mbajtës i letërnjoftimit nr.033785771, banues në adresën: Rruga e Vilave, Rezidenca Sunrise, Tiranë.

31.3 Administratorët emërohen në detyrë për një afat 3 (tre) vjeçar.

31.4 Kontrata e angazhimit dhe shpërblimi i Administratorit miratohet me vendim të Këshillit Mbikëqyrës.

### **Neni 32** **Kompetencat e Administratorit**

32.1 Administratori është i ngarkuar me administrimin e aktivitetit të përditshëm të Shoqërisë dhe përfaqësimin e saj në raport me çdo palë të tretë.

32.2 Administratori do të vendosë për çdo çështje që nuk është kompetencë ekskluzive e Asamblesë së Përgjithshme ose e Këshillit Mbikëqyrës së Shoqërisë, përfshirë por pa u kufizuar në sa më poshtë vijon:

- a. Të sigurojë mbajtjen dhe administrimin e duhur të librave dhe dokumenteve të kontabilitetit.
- b. Të kujdeset për përgatitjen, e të nënshkruajë pasqyrat financiare vjetore dhe bilancin dhe raportin e performancës, e t'ia paraqesë ato për miratim Këshillit Mbikëqyrës e më pas Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve, së bashku me propozimin për shpërndarje të fitimeve apo mbulime të humbjeve.
- c. Të krijojë një sistem monitorimi të hershëm për zhvillim e që kërcenojnë ekzistencën e Shoqërisë.
- d. Të kryejë çdo regjistrim ose publikim të të dhëna vetë Shoqërisë që kërkohet sipas Legjislacionit të Zbatueshëm.



e. Të njoftojë menjëherë Kryetarin e Këshillit Mbikëqyrës dhe Asamblenë e Përgjithshmet ë Aksionarëve ne rastet e parashikuara nga pikat 3, 4 dhe 5 të nenit 136 te Ligjit Nr. 9901 për Shoqëritë Tregtare.

32.3 Administratori do t'i raportojë drejtpërdrejt Këshillit Mbikëqyrës dhe do të zbatojë të gjithë urdhrat dhe vendimet e Këshillit Mbikëqyrës. Përveçse kur kërkohet ndryshe nga Këshilli Mbikëqyrës, Administratori do të marrë pjesë në të gjitha mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës.

32.4 Përveçse kur parashikohet ndryshe në Statut, Administratori autorizohet të ndërmarrë veprime në emër të dhe për interes të Shoqërisë në përputhje me këtë Statut, Planet e Detajuara të Punës, Buxhetin dhe politikat e procedurat e përcaktuara nga Këshilli Mbikëqyrës.

32.5 Administratori do t'i japë çdo Aksionari të gjithë informacionin përkatës rreth Shoqërisë, nëse kërkohet nga Aksionari, përfshirë edhe informacionin për transaksionet apo marrëdhëniet me personat e lidhur dhe palët e treta.

### **Neni 33**

#### **Largimi i Administratorit/ëve**

33.1 Administratori/ët nëpërmjet dorëheqjes, mund të largohet për çfarëdo arsye nga pozicioni i tij, brenda 30 ditëve kalendarike nga njoftimi me shkrim drejtuar Këshillit Mbikëqyrës. Administratori/ët që jep/japin dorëheqjen, duke patur parasysh rrethanat e veprimtarisë së Shoqërisë, është i detyruar të thërrasë Mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës për emërimin e Administratorit të ri, përpara datës kur dorëheqja të hyjë në fuqi.

33.2 Nëse Këshilli Mbikëqyrës nuk vendos emërimin e Administratorit të ri, në datën e përcaktuar në thirrjen e kryer nga Administratori i dorëhequr, atëherë ky i fundit i njofton me shkrim dorëheqjen Qendrës Kombëtare të Biznesit, së bashku me kopjen e thirrjes së mbledhjes së Këshillit Mbikëqyrës, me qëllim regjistrimin e largimit të tij, në përputhje me përcaktimet e Legjislacionit të Zbatueshëm.

33.3 Deri në momentin e zgjedhjes së Administratorit të ri nga Këshilli Mbikëqyrës, administrator i përkohshëm do jetë një nga drejtuesit pjesë e strukturës së shoqërisë.

33.4 Administratori i ri i emëruar nga Këshilli Mbikëqyrës, do të mbetet në detyrë deri në përfundimin e mandatit të Administratorit të zëvendësuar.

33.5 Këshilli Mbikëqyrës mund të shkarkojë nga detyra Administratorin në çdo kohë, me shumicë të thjeshtë nëpërmjet një njoftimi të dërguar për këtë qëllim. Në një rast të tillë, shkarkimigadetyrahyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit nga ana e Administratorit.

#### **Neni 34**

##### **Bordet këshillimore të parkut (Bordet)**

34.1 Pranë organeve drejtuese të Shoqërisë ngrihet Bordi i Partnerëve Publik të parkut si dhe Bordi i Përdoruesve të Parkut, dy organe këshillimore të shoqërisë, të krijuara respektivisht nga institucionet publike të përcaktuara në marrëveshjen e MEKI me Zhvilluesin si dhe nga Përdoruesit pjesë e Listës së Përdoruesve të Parkut Durana sipas përcaktimeve të rregullores së shoqërisë.

34.2 Bordet këshillimore mund të ngrenë komitete koordinuese me anëtar respektivisht institucionet publike të përcaktuara nga MEKI si dhe me anëtarësi të hapur/ekskluzive vetëm për ata përdorues që tejkalojnë një kapacitet financiar të xhiros vjetore sipas parashikimeve të Rregullores së Shoqërisë, Marrëveshjes me MEKI si dhe Legjislacionit të Zbatueshëm,

#### **Neni 35**

##### **Kryetari dhe Nënkyetari i Bordit**

35.1 Bordi/et zgjedh/in midis anëtarëve Kryetarin dhe Nënkyetarin, të cilët kanë si detyrë thirrjen e mbledhjeve të Bordit, përcaktimin e programit të mbledhjes, si dhe drejtimin e diskutimeve.

35.2 Në mungesë të Kryetarit mbledhjet e Bordit drejtohen nga Nënkyetari, ose në mungesë të Nënkyetarit, nga një anëtar tjetër i Bordit me vendim të shumicës së anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

#### **Neni 36**

##### **Kompetencat e Bordit të përdoruesve të parkut**

36.1 Bordi ka funksion këshillues në raport me Këshillin Mbikëqyrës, Administratorin, dhe Asamblenë e Aksionarëve. Bordi vepron me iniciativën e tij, me kërkesë të Këshillit, Administratorit, ose Asamblesë.

36.2 Bordi referuar këtij statuti ka këto kompetenca:

- a. Këshillimi mbi strategjinë e zhvillimit-Bordi mund të ofrojë sugjerime dhe rekomandime për strategjitë afatshkurtra dhe afatgjata për zhvillimin dhe zgjerimin e parkut, duke përfshirë fushat e kërkimit dhe inovacionit.
- b. Përfaqësimi i interesave të përdoruesve - Bordi do të përfaqësojë interesat e përdoruesve përpara menaxhimit të parkut dhe organeve të tjera vendimmarrëse, duke ndihmuar në ruajtjen e një dialogu të hapur dhe konstruktiv.
- c. Sugjerime dhe rekomandime lidhur me përdoruesit e rinj që bëhen pjesë e parkut si dhe identifikimin e nevojave të tyre - Bordi mund të mbledhë dhe përcjellë nevojat dhe sfidat e përdoruesve të rinj në park, duke ndihmuar menaxhimin e parkut në drejtime dhe mënyra konkrete se si mund të përkthehen dhe përshtaten këto nevoja.



- d. Mbikëqyrja e bashkëpunimeve teknologjike - Bordi mund të monitorojë dhe mbështesë krijimin e parteneriteteve midis përdoruesve të parkut, duke promovuar ura bashkëpunimi ndërmjet si përmarrësve teknologjikë dhe institucioneve akademike për inovacion dhe kërkime.
- e. Rishikimi i shërbimeve dhe infrastrukturës - Bordi mund të shqyrtojë dhe të bëjë rekomandime për përmirësimin e shërbimeve të ofruara në park (si inkubatorët e bizneseve, laboratorët e përbashkët, ambientet për takime, dhe qendrat e trajnimit).
- f. Monitorimi i politikave dhe rregulloreve - Bordi do të sigurohet që rregulloret dhe politikat e parkut të jenë të përshtatshme për përdoruesit dhe do të ofrojë sugjerime përpërmirësime bazuar në nevojat operationale.
- g. Rishikimi i tarifave dhe çmimeve - Bordi mund të jetë pjesë e procesit të vlerësimit të tarifave për shërbime dhe infrastruktura brenda parkut, duke siguruar që kostot janë të arsyeshme dhe konkurruese.
- h. Promovimi i inovacionit dhe zhvillimit teknologjik - Bordi mund të inkurajojë dhe mbështesë projektet inovative dhe start-up-et brenda parkut, duke ofruar input dhe duke ndihmuar në përvetësimin e praktikave më të mira në park sa i takon fushës së teknologjisë dhe inovacionit.

### **Neni 37**

#### **Mbledhjet e Bordeve këshillimore**

37.1 Mbledhjet e Bordeve këshillimore mbahen në selinë e parkut Teknologjik, por mund të zhvillohen gjithashtu nëpërmjet telekonferencës apo me mjete të ngjashme komunikimi, sipas kërkesës së kryetarit të mbledhjes apo të shumicës së anëtarë vetë tij.

37.2 Kuorumi i nevojshëm për vlefshmërinë e mbledhjes arrihet nëse në mbledhje janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të Bordit.

37.3 Bordi mblidhet rregullisht të paktën dy herë në vit, me kërkesë të Kryetarit apo shumicës së anëtarëve të tij, Këshillit Mbikëqyrës ose Administratorit të shoqërisë.

37.4 Pjesëmarrja në mbledhje është e paguar. Vlera e shpërblimit përcaktohet me vendim të Këshillit Mbikëqyrës.

### **Neni 38**

#### **Njoftimi i mbledhjes së bordeve këshillimore**

38.1 Njoftimi i mbledhjes, në të cilën përcaktohen ora, dita, vendi si dhe rendi i ditës, duhet tu dërgohet të gjithë anëtarëve të bordit nëpërmjet postës së zakonshme ose postës elektronike të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, para datës së caktuar për mbledhje. Ky afat mund të zvogëlohet në 24 (njëzet e katër) orë, në raste urgjence.





38.2 Mbledhja e bordit quhet e thirrur rregullisht edhe pa përmbushur këto formalitete, nëse të gjithë anëtarët e bordit janë të pranishëm.

38.3 Pala apo palët thirrëse vënë gjithashtu në dispozicion të cdo anëtari të Bordit të gjithë informacionin apo dokumentacionin e nevojshëm, për çështjet që trajtohen të paktën 7 (shtatë) ditë, para datës së caktuar përmbledhjen dhe në rast urgjence, 24 (njëzet e katër) orë para.

#### **Neni 39**

#### **Vendimarrja e bordeve këshillimore**

39.1 Bordi synon të formulojë opinione dhe rekomandime bazuar në konsensus. Në rast kur nuk mund të arrihet konsensus, bordi formulon qëndrimet e tij me shumicën e anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

39.2 Në rast barazie votash, vota e kryetarit ose e drejtuesit të mbledhjes është vendimtare.

39.3 Opinionet dhe rekomandimet e Bordit i dërgohen për informim Këshillit Mbikqyrës së shoqërisë, i cili në mbledhjen e ardhshme vendos ti pranojë ose jo në vendimarrjen e tij.

#### **Neni 40**

#### **Bordi i partnerëve publik**

40.1 Bordi i partnerëve publik përbëhet nga përfaqësues të ministrive përgjegjëse për ekonominë, inovacionin, energjinë, infrastrukturën, migracionin, startup, agjencia përgjegjëse për tatimet dhe agjencia përgjegjëse për doganat dhe ka për kompetencë përcjelljen e rekomandimeve dhe këshillave me qëllim mirëfunksionimin e parkut. Me kërkesë të Këshillit Mbikqyrës mund të kërkohej të japi rekomandime në lidhje me çështjet e fushave të përgjegjësisë së anëtarëve të saj.

### **KREU IV**

### **BUXHETI, KONTABILITETI, ÇËSHTJET TATIMORE, DIVIDENDI**

#### **Neni 41**

#### **Buxheti**

41.1 Jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarikë përpara çdo Viti Financiar, Administratori do t'i paraqesë Këshillit Mbikqyrës, Buxhetin e propozuar për Vitin e Ardhshëm Financiar, i cili do të jetë në formë dhe në përmbajtje siç është përcaktuar nga Këshilli Mbikqyrës. Sa më parë të jetë e mundur, por në çdo rast përpara fillimit të Vitit Financiar përkatës, Administratori do t'i paraqesë Këshillit Mbikqyrës Buxhetin e propozuar për çdo muaj kalendarik të Vitit Financiar përkatës.

Në vazhdim të sa më sipër, Buxheti i miratuar nga Këshilli Mbikqyrës do t'i nënshtrohet rishikimit dhe miratimit nga Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve.

41.2 Administratori do t'i dorëzojë Këshillit Mbikëqyrës raporte (financiare ose të tjera) dhe buxhetet sipas kërkesave së Këshillit Mbikëqyrës.

#### **Neni 42 Raportet Periodike**

42.1 Shoqëria do të përgatisë dhe do t'u japë anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, sa më shpejt të jetë e mundur dhe në formën dhe përmbajtjen e përcaktuar nga Këshilli Mbikëqyrës, llogaritë tre mujore të pa audituara të menaxhimit të Shoqërisë, brenda 45 (dyzet e pesë) ditësh kalendarike pas përfundimit të çdo tremujori. Çdo raport tremujor duhet të përfshijë edhe parashikimet e buxhetit për humbjet dhe fitimet dhe pasqyrën financiare të Shoqërisë.

42.2 Shoqëria do t'i paraqesë këto raporte si dhe çdo raport tjetër shtesë kur ato kërkohen në mënyrë të arsyeshme dhe kur kërkohen për të qenë në përputhje me praktikën e raportimit financiar të secilit Aksionar, duke marrë parasysh ngarkesën e punës së stafit të Shoqërisë.

42.3 Aksionarët në rast se janë më shumë se 1, bien dakord të bashkëpunojnë plotësisht dhe t'i japin njëri-tjetrit, sipas kërkesës, të gjithë informacionin e nevojshëm financiar dhe analizën përkatëse të çdo llogarie për interesat e tyre përkatëse në Shoqëri.

#### **Neni 43 Librat dhe Regjistrat, Përputhshmëria**

43.1 Administratori zotohet se do të bëjë të gjitha përpjekjet e tij të arsyeshme, për t'u siguruar se Shoqëria do të mbajë libra të rregullt të shitjeve/blerjeve dhe do të regjistrojë me vërtetësi dhe plotësi të gjitha të dhënat e marrëveshjeve dhe transaksioneve të Shoqërisë.

43.2 Shoqëria do të mbajë libra dhe regjistra të rregullt në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm, libra dhe regjistra të cilët do të mbahen në çdo rast në selinë e regjistruar të Shoqërisë. pa u kufizuar me sa më lart, Shoqëria mban në selinë e vetë të regjistruar, dokumentet e mëposhtme:

- a. Listën aktuale të emrave të plotë dhe të adresës së vendbanimit/postës elektronike të Aksionarëve dhe Anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës.
- b. Kopjen e Statutit dhe të gjitha ndryshimeve të tij.
- c. Kopjet e deklaratave tatimore të Shoqërisë dhe raporteve, nëse ka, për 3 (tre) Vitet Financiare më të fundit.
- d. Kopjet e pasqyrave financiare, nëse ka, të Shoqërisë për 5 (pesë) Vitet Financiare më të fundit.
- e. Dokumente të tjera lidhur me aktivitetin e Shoqërisë, sikurse mund të kërkohet në mënyrë të arsyeshme herë pas here nga vendimet e Mbledhjes së Asamblesë ose Këshilli Mbikëqyrës.

43.3 Shoqëria bën përpjekjet më të mira për të mbajtur në fuqi të plotë të gjitha miratimet, pëlqimet dhe licencat e nevojshme për realizimin e aktivitetit të Shoqërisë.

#### **Neni 44**

##### **Audituesit e Shoqërisë**

44.1 Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës bien dakord të emërojnë auditues financiar kombëtar/ndërkombëtarë të mirënjohur me qëllim që të bëjnë auditet e pasqyrave të Shoqërisë në fund të Vitit Fiskal.

44.2 Këshilli Mbikëqyrës do t'i rekomandojë Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të Shoqërisë, të miratojë një firmë auditimi, për të kryer auditimet financiare.

44.3 Aksionarët bien dakord se, audituesi i parë ligjor i shoqërisë, do të jetë Mazars sh.p.k, shoqëri e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) me NIPT K32123006W dhe seli në adresën Rr. "Emin Duraku", nr.5, 1009, Tiranë – Shqipëri;

44.4 Audituesi ligjor do të emërohet për një afat kohor prej një viti, me të drejtë ripërtëritje.

#### **Neni 45**

##### **Politika e Shpërndarjes së Dividendit**

45.1 Palët bien dakord se Shoqëria do ta ushtrojë aktivitetin duke ushtruar politikën e shpërndarjes së dividendëve si parim drejtues, sipas parashikimeve të këtij Neni.

45.2 Koha e shpërndarjes dhe shuma e dividendit që do t'u shpërndahet Aksionarëve do të vendoset duke marrë në konsideratë aktivitetin, Buxhetin dhe performancën financiare të Shoqërisë.

#### **KREU V**

##### **TË NDRYSHME**

#### **Neni 46**

##### **Deklaratat dhe Garancitë**

46.1 Secili Aksionar, deklaron dhe i garanton shoqërisë, që nga data e këtij Statuti, si më poshtë vijon:

- a. Aksionari është i organizuar në mënyrë të rregullt, ekziston në mënyrë të vlefshme dhe sipas Legjislacionit të Zbatueshëm dhe ka zotësi të plotë juridike, si dhe zotëron franchise, licensa, leje, autorizime dhe miratime të nevojshme për t'i mundësuar marrjen në pronësi, marrjen me qira ose mbajtjen e pasurive dhe asetëve të tij, duke përfshirë Aksionet dhe kryerjen e aktivitetit, siç është kryer aktualisht.
- b. Aksionari ka fuqi dhe zotësi të plotë për nënshkrimin e këtij Statuti. Nënshkrimi dhe zbatimi nga ky Aksionar i këtij Statuti, është autorizuar në mënyrë të rregullt, nëpërmjet të gjitha veprimeve të nevojshme. Ky Aksionar e ka nënshkruar dhe zbatuar këtë Statut në mënyrë të rregullt, dhe ky Statut përbën detyrimin e tij ligjor, të vlefshëm dhe detyrues, të zbatueshëm ndaj tij në përputhje me kushtet e tij.





## **Neni 47**

### **Politika e Përgjegjësisë Sociale të Shoqërisë**

47.1 Aksionarët do të përpiqen të ndjekin standardet, udhëzimet dhe parimet e njohura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për përgjegjësinë sociale të Shoqërisë, që janë mbështetur ose përkrahen nga Aksionarët, duke përfshirë Udhëzimet e OECD-së për Ndërmarrjet shumëkombëshe. Aksionarët dhe Shoqëria do të inkurajojnë çdo Person që është apo që do të përfshihet lidhur me Projektin, që t'i përfshijë vullnetarisht këto standarde, udhëzime dhe parime në praktikën e tyre të punës dhe politikën e tyre të brendshme. Këto standarde, udhëzime dhe parime, trajtojnë çështje si: puna, mjedisi, barazia gjinore, të drejtat e njeriut, marrëdhëniet me komunitetin dhe antikorrupsionin.

47.2 Përpos parashikimeve të pikës 47.1, Aksionarët bien dakord se si pjesë e angazhimit të përgjegjësisë sociale të shoqërisë, Shoqëria do të përfshijë parashikime të posaçme në Planin e Detajuar të Biznesit dhe në Buxhet, për të kontribuar në, dhe mbështetur ngritjen e kapaciteteve dhe programet e punësimit të rinjve në fushat e teknologjisë të përcaktuara në VKM Nr. 185/2024. Ky kontribut dhe kjo mbështetje mund të përfshijë bursa, trajnime, projekte kërkimore dhe inovacioni të ofruara përmes DURANA Tech Park dhe organeve të tjera arsimore publike në fushën e teknologjisë, si dhe krijimin e lidhjeve me rëndësi në nivel kombëtar dhe rajonal, në kuadër të bashkërendimit të Shqipërisë me acquis-in dhe standardet e Bashkimit Evropian.

## **Neni 48**

### **Veçueshmëria**

48.1 Termat, kushtet dhe dispozitat e këtij Statuti janë plotësisht të veçueshme, dhe vendimi ose Gjykimi i ndonjë gjykate të juridiksionit kompetent, që shpall të pavlefshëm ose të pazbatueshëm një ose më shumë terma, kushte ose dispozita, nuk shpall të pavlefshëm ose të pazbatueshëm asnjë prej termave, kushteve ose dispozitave të tjera të saj dhe ky term i pavlefshëm ose i pazbatueshëm, do të zëvendësohet me një term të vlefshëm dhe të zbatueshëm, që do të pasqyrojë në masën më të madhe të mundshme, qëllimet fillestare të Aksionarëve në këtë dokument.

## **Neni 49**

### **Ndryshimet, Heqje dorë**

49.1 Ndryshimet në këtë Statut, mund të bëhen herë pas here; me kushtin që, asnjë ndryshim apo modifikim i Statutit apo ndonjë dispozite të tij, të mos jetë i vlefshëm ose në fuqi, përveçse me shkrim dhe me nënshkrimin nga secili Aksionar.

49.2 Asnjë miratim, ose heqje dorë, anulim ose lirim (secili, "Heqje dorë") prej ndonjë dispozite apo shkeljeje të këtij Statuti, nuk do të jetë i vlefshëm ose në fuqi, përveçse me shkrim dhe me nënshkrimin nga Aksionari që bën këtë Heqje dorë, dhe asnjë Heqje dore specifike nuk përbën Heqje dore në lidhje me ndonjë dispozitë ose shkelje tjetër, me natyrë të ngjashme ose jo.



## **Neni 50 Prishja dhe Likuidimi**

50.1 Në rast likuidimi të Shoqërisë, në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm dhe vendimin e posaçëm të Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve, likuiduesi mund të shpërndajë për interes të Aksionarëve, të gjithë ose një pjesë të aseteve të Shoqërisë, dhe për këtë qëllim mund të vlerësojë çdo aset dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes ndërmjet Aksionarëve.

## **Neni 51 Njoftimet**

51.1 Për sa kohë nuk parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë Statut, çdo njoftim, pretendim, kërkesë, pyetje, pëlqim, miratim apo komunikim tjetër ndaj Aksionarit në të, kryhet në gjuhën angleze dhe shqipe dhe konsiderohet si i kryer ose i dhënë në rastin kur bëhet me shkrim dhe dorëzohet personalisht me konfirmim dorëzimi, ose kur dërgohet me postë të regjistruar (*të parapaguar*), faks ose shërbim korrier (*të parapaguar*) te Aksionari në fjalë, në adresën përkatëse të përcaktuar më poshtë. Të gjitha njoftimet do të dërgohen edhe përmes një email-i për lehtësi, pa u konsideruar si njoftim sipas kësaj Marrëveshjeje. Të gjitha njoftimet dhe komunikimet e tjera konsiderohen të kryera në datën e marrjes nga personi i adresuar.

51.2 Aksionari AIC do të njoftohet në adresën e selisë së shoqërisë.

**Për Aksionarin AIC: Korporata e Investime Shqiptare" SHIA**

**Adresa:** Rr. Ibrahim Rugova 5, Sky Tower 7/1, Tiranë - Shqipëri

**E-mail:** info@aicorporation.al

## **Neni 52 Shpenzimet për tarifa**

52.1 Aksionarët bien dakord se do të financojnë bashkërisht dhe në mënyrë proporcionale shpenzimet e themelimit dhe regjistrimit të Shoqërisë.

## **Neni 53 Dispozita përfundimtare**

53.1 Për gjithçka që nuk parashikohet në këtë Statut, zbatohen dispozitat në fuqi të Legjislacionit të Zbatueshëm.

### **Aksionari i Vetëm**

**KORPORATA E INVESTIMEVE SHQIPTARE SHIA**  
*Përfaqësuar sipas Vendimit të Këshillit Mbikqyrës dt 31.01.2025*

**Drejtori Ekzekutiv**  
Znj. ELIRA KOKONA

